

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për krime të rënda- kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Tonka Berishaj dhe Have Haliti, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R.P., nga fshati ..., për shkak të tri veprave penale - marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.174/2015, të dt.14.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, me datën 21.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, kurse aktgjykimi Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.174/2015, të dt.14.06.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.174/2015, i akuzuari R.P., në bazë të nenit 364 par.1pika 3 të KPP, është liruar nga akuza për tri vepra penale - marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK.Për shpenzimet e procedurës penale është vendos që të bijën në barrë të mjeteve buxhetore. Lidhur me kërkesën pasurore të dëmtuarit B.P., Z.I. dhe I.R., janë udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Themelore-DKR në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Prokurori i Apelit të Kosovës me parashtresën PPA/I.nr.380/17 të dt.31.08.2017, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën palët nuk janë njoftuar, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me aktgjykim lirues, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje penale juridike dhe aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK dhe pas vlerësimeve të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Prokuroria në ankesë pretendon se aktgjyrimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pa precizuar dispozitën ligjore, por vetëm thekson se arsyetimi i aktgjykimit është kontradiktorë dhe kundërthënës me dispozitivin e aktgjykimit sepse nga arsyetimi i aktgjykimit rezulton se i akuzuari e ka kryer veprën penale të përshkruar si në pikën II të dispozitivit dhe kjo vërtetohet nga përshkrimi i deklaratës të dëmtuarit të paraqitur në faqen 4 të arsyetimit të këtij aktgjykimi, ndërsa raportet policore për kujdestari, në të cilat gjykata e bazon aktgjykimin, nuk mund të vlerësohen si prova të pranueshme sepse nuk ishin të vulosura e as të nënshkuara. Po ashtu thekson se edhe nga deklaratat e të dëmtuarve B.P. dhe I.R., vërtetohet se i akuzuari i ka kryer edhe veprat penale të përshkuara nën pikën I dhe III të aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara.

Sipas gjetjes së Gjykatës së Apelit aktgjyrimi i ankimuar është i hartuar ashtu si është parashikuar me dispozitën e nenit 370 të KPPK. Në arsyetimin e aktgjykimit në mënyrë të qartë dhe të plotë janë paraqitur arsyet për çdo provë të administruar, gjegjësisht arsyet për faktet të cilat gjykata i konsideron të pavërtetuara.

Arsyet e dhëna nga ajo gjykatë janë të qarta dhe nuk janë në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit, si pa të drejtë pretendohet në ankesë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse në mes të provave tjera të administruara duke dhënë arsye se pse të akuzuarit nuk mund të shpallë fajtorë duke u bazuar vetëm në deklaratat e dëshmitarëve B.P. dhe I.R. për veprat penale si nën pikën I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit. Është fakt se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit u referohet deklaratave të këtyre dëshmitarëve të dhënë në inspektoratin policor kur kanë paraqitur rastet, por gjithashtu ajo gjykatë jep edhe arsye pse nuk ka arritur që të njëjtit ti dëgjoj në cilësi të dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor, gjegjësisht veprimet që ka ndërmarrë për të siguruar prezencën e tyre në shqyrtimin gjyqësor.

Nga shkresat e lëndës rezulton se dëshmitarët B.P. dhe I.R. ishin të paarritshëm për gjykatën sepse jetojnë në Serbi dhe për shkak të raporteve në mes dy shteteve nuk ka pasur mundësi që deklaratat e tyre të sigurohen nëpërmes ndihmës ndërkombëtare. Nga shikimi i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të dt. 12.06.2017, rezulton se gjykata e shkallës së parë duke vepruar në pajtim me nenin 338 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK, i ka lexuar deklaratat e dëshmitarëve B.P. dhe I.R., të cilat i ka kundërshtuar mbrojtja.

Pra, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur i ka lexuar deklaratat në fjalë pa pëlqimin e të akuzuarve pasi që ata ishin të paarritshëm, si parashikon dispozita e nenit 338 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK, mirëpo, duke pasur parasysh faktin se këta dëshmitarë janë dëgjuar vetëm në inspektoratin policor pa iu dhënë mundësia të akuzuarve apo mbrojtësve të tyre për ti kundërshtuar në ndonjë fazë të procedurës, atëherë i drejtë është edhe konkludimi i asaj gjykate se të akuzuarit konform nenin 262 par. 1 të KPPK, nuk mund të shpallën fajtor duke u bazuar vetëm në deklaratat e këtyre dëshmitarëve.

Në fakt, me dispozitën e nenit 123 par. 3 të KPPK parashikohet se ‘‘.....deklarata në procedurë paraprake pranohet gjatë shqyrtimit kryesor për marrje e tërthortë në pyetje të dëshmitarit të njëjtë dhe mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë në shqyrtimin kryesorë nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mungesës së pranisë së tij në Kosovë, por nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare fajësuese për të pandehurin.

Ndërsa, me dispozitën e nenit 262 par. 1 të KPPK parashikon se gjykata nuk mund ta shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë në të njëjtën mënyrë përkritazi me veprën penale të përshkruar nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar në faqen 4 të arsytimitin e aktgjykimit paraqet përmbajtjen e deklaratës të dëshmitarit Z.I., por gjithashtu jep edhe arsye se pse nuk ja ka falë besimin kësaj deklarate.

Nga arsyet që u thanë më lartë, kjo Gjykatë gjënë si të pabazuara pretendimet e Prokurorit, se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Për sa i takon bazës ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, Prokurori në esencë konteston mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet që i ka nxjerrë ajo gjykatë në bazë të provave që i kishte proceduar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara.

Për veprat penale nën pikën I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit kjo Gjykatë vlerëson se nuk është e nevojshme që edhe një herë të përsëritën ato që janë thënë më lartë përkitazi me deklaratat e dëshmitarëve B.P. dhe I.R., me të cilat sipas pretendimeve ankimore vërtetohet gjendja faktike e përshkruar si nën pikën I dhe III të aktgjykimit të ankimuar, sepse të gjitha ato që janë thënë përkitazi me këto vepra penale në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, si të drejta i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Përkitazi me veprën penale të përshkruar nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, Prokurori pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ia falë besimin deklaratës të dëshmitarit Z.I., por aktgjykimin lirues e mbështet në raportin e ndërrimit të Drejtorisë Rajonale të veriut – Policia Kufitare në Luzhanë, i cili nuk është i vulosur dhe i nënshkruar, prandaj si i tillë nuk mund të jetë provë e pranueshme.

Po ashtu edhe këto pretendime ankimore janë të pabazuara sepse nga shikimi i shkresave të lëndës dhe aktgjykimi i ankimuar del se koha e kryerjes së veprës penale - përshkrimi faktik nën pikën II të dispozitivit, për të cilën është akuzuar i akuzuari R.P. është data 28.01.2013, rreth orës 23:30 minuta, ndërsa nga deklaratat e dëshmitarit Z.I., të dhëna në gjitha fazat e procedurës penale rezulton se koha e kryerjes së veprës penale është data 28.01.2013, rreth orës 23:30 minuta. Mirëpo, nga shikimi i Raportit të ndërrimit të Drejtorisë Rajonale Veri-Luzhan, me shenjë TIM-3 për datën 28.01.2013, vërtetohet se i akuzuari R.P., si udhëheqës i ndërrimit në patrullë me S.V. dhe Z.G., ka qenë në ndërrimin e ditës prej orës 08:00 deri në ora 16:00. Shkresa në fjalë është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me dt. 26.05.2017, është e vulosur me vulën e MPB-policia e Kosovës-Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit Lepasviq dhe është e nënshkruar nga polici me nr. 2740, prandaj gjykata nuk ka pas arsye të dyshoi në valeditetin e tij pasi që është lëshuar, vulosur dhe nënshkruar nga organi zyrtar. Pra, në këtë raport konstatohet se i akuzuari ditën kritike ka qenë në ndërrim deri në ora 16:00 dhe për këtë arsye gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk ia fal besimin deklaratës dëshmitarit Z.I. i cili ka deklaruar se patrulla e policisë në mesin e cilëve ka qenë edhe i akuzuari R.P., e ka ndaluar rreth orës 23:30, ndërsa me asnjë provë konkrete të organit kompetent nuk është vënë në dyshim saktësia e këtij Raporti.

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipërpërmendura si dhe rrethanat më detaisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar është i drejtë, me ç'rast drejtë ka zbatuar edhe ligjin penal.

Për këto arsye ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë u refuzua, kurse aktgjykimi i ankimuar u deshtë të vërtetohet.

Nga çka u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.396/2017 me date 21.09.2017

Procesmbajtës,	Anëtarët e kolegjit,	Kryetari i kolegjit,
Bujar Bala	Tonka Berishaj_____	Xhevdet Abazi
	Hava Haliti_____	